

1 E martë, 5 korrik 2022

2 [Konferencë para apelit]

3 [Seancë e hapur]

4 [Apeluesi Haradinaj hyn në sallën e gjyqit]

5 [Apeluesi Gucati nuk është i pranishëm]

6 --- Fillon në orën 14.00

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirëdita

8 dhe mirë se keni ardhur të gjithë. Unë jam Gjykatësja Picard,

9 që jam Kryegjykatëse në këtë çështje.

10 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem a mund të thërrisni

11 çështjen.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

13 Gjykatës. Kjo është çështje KSC-CA-2022-01, Prokurori i

14 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

16 Faleminderit. Tani i drejtohem Mbrojtjes duke filluar me

17 avokatin e z. Gucati.

18 Z. REES: [Përkthim] Përshëndetje, e nderuar Gjykatëse.

19 Unë jam përfaqësuesi i z. Gucati dhe jam së bashku këtu me z.

20 Halilaj dhe kolegun tjetër.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Avokati për

22 z. Haradinaj.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë jam këtu në emër të z.

24 Haradinaj dhe me mua janë edhe dy kolegë të tjerë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani koha për Zyrën Administrative.

3 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse, të
4 nderuar kolegë, mirëdita. Unë jam z. Jonas Nilsson,
5 Përfaqësues i Zyrës Administrative.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Vë re që z.
7 Haradinaj është i pranishëm në sallën e gjyqit dhe vërej
8 gjithashtu që z. Gucati ka hequr dorë nga e drejta e tij për
9 të qenë i pranishëm në këtë seancë.

10 Harrova ZPS-në, ju kërkoj ndjesë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Pa problem, e nderuar Gjykatëse.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Është hera
13 e parë.

14 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptoj plotësisht.

15 Në emër të ZPS-së sot është i pranishëm z. Whiting, që
16 është z. Prokuror i Përgjithshëm; janë të pranishëm gjithashtu
17 edhe James Pace; dhe Matt Halling; Line Pedersen është
18 gjithashtu e pranishme nga ana e Prokurorisë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Përpara se
20 sa të fillojmë, më lejoni të them se Gjykatësi Ambos dhe
21 Gjykatësja Jorgensen si dhe unë jemi caktuar në Gjykatën e
22 Apelit për të vendosur për këtë apel kundër Aktgjykimit që
23 është nxjerrë lidhur me këtë çështje me datë 18 maj 2020
24 [sipas përkthimit].

25 Në pajtim me rregullën 178 të Rregullores, qëllimi i

1 kësaj konference përpara apelit është që t'i jepet mundësia të
2 akuzuarit të ngrenë çështjet lidhur me ndalimin e tyre
3 përfshirë edhe gjendjen e tyre mendore dhe fizike. Për këtë
4 qëllim me datë 22 qershor 2020 [sipas përkthimit], unë nxora
5 këtë urdhër në emër të Trupit Gjykues për të mbledhur
6 konferencën para apelit dhe për të përcaktuar axhendën për
7 këtë seancë.

8 Për seancën e ditës së sotme, dua t'ju kërkoj palëve të
9 paraqesin parashtrimet e tyre në mënyrë koncize dhe të
10 shmangin përsëritjen e parashtrimeve me shkrim për çështje të
11 cilat ose janë pezull, në pritje të vendimit nga Trupi Gjykues
12 ose të cilat janë trajtuar prej Trupit Gjykues. Këtu i
13 referohem kërkesës së ZPS-së për të mbajtur të ndaluar të
14 akuzuarit. Kjo çështje do të vendoset me shkrim.

15 Gjithashtu i referohem kërkesës së z. Haradinja lidhur me
16 zgjatjen e numrit të fjalëve për parashtrimin e apelit dhe
17 kërkesës së ZPS-së lidhur me ridorëzimin e njoftimit të apelit
18 nga z. Haradinaj. Palët janë njoftuar për vendimin e Trupit
19 Gjykues të premtën e shkuar.

20 Po ashtu, Trupi Gjykues ka rrëzuar kërkesën e parashtruar
21 nga z. Gucati për zgjatjen e fjalëve për riparashtimin e
22 njoftimit të apelit në vendimin e dorëzuar më herët sot.

23 Dua që t'ju kujtoj që ta përdorim kohën në mënyrë sa më
24 efikase të jetë e mundur dhe që kjo seancë duhet të përfundojë
25 deri në fund të ditës sot.

1 Dua që t'ju kujtoj të gjithëve që duhet të respektojmë
2 disa rregulla në mënyrë të tillë që të sigurojmë një proces
3 gjyqësor të saktë dhe efektiv, duke marrë parasysh nevojën e
4 përkthimit të mirë do të na kërkohet ndonjëherë pak kohë
5 shtesë që të presim përpara se sa të fillojmë me të folurin.

6 Kështu që do të doja që t'ju kujtoja që ky është një
7 proces gjyqësor i cili transkriptonet në kohë reale dhe ky
8 transkript ju vuhet në dispozicion palëve dhe publikut.

9 Ju kujtoj palëve që të japin njoftim paraprak në qoftë se
10 do të përmendin informacion konfidencial në mënyrë që të
11 kalojmë në seancë private ose me dyer të mbyllura.

12 Sipas urdhrit për caktimin e seancës për ditën e sotme,
13 ne së pari do të dëgjojmë parashtrimet e lidhura me
14 paraburgimin e të akuzuarve. Gjithashtu, informoj Zyrën
15 Administrative që do të ftoja parashtrimet për sa i takon
16 përkthimit të Aktgjykimit në shqip dhe kur pritët që të
17 përfundohet ky përfundim, ky përkthim.

18 Po ashtu kam edhe disa çështje të tjera dytësore që do të
19 doja që të ngrija në emër të Trupit Gjykues.

20 Trupi Gjykues dhe palët janë njoftuar që Mbrojtja për z.
21 Haradinaj kërkoi që të, kërkon qartësi lidhur me apelin
22 material në qoftë se apeli do të bëhet me shkrim apo në qoftë
23 se do të bëhet me seanca gojore.

24 Z. Gucati, Mbrojtja për z. Gucati nuk e ka informuar
25 Trupit Gjykues për çështje të tjera shtesë, që të trajtohen

1 sot.

2 Në fund, dua të vërej që ZPS-ja nuk dëshiron që të ngrejë
3 ndonjë çështje shtesë sot. Seanca e ditës së sotme do të
4 përfundojë në përputhje me këtë axhendë.

5 Pra, dua që së pari të ftoj Mbrojtjen duke filluar me
6 Mbrojtjen e z. Gucati dhe më pas Mbrojtjen për z. Haradinaj që
7 të ngrenë çështje që kanë të bëjnë me mbajtjen në paraburgim
8 të të akuzuarve të tyre.

9 Ju rikujtoj Mbrojtjes që të kërkojnë që të kalojmë në
10 seancë private në qoftë se dëshirojnë t'i referohen
11 informacionit konfidencial që ka të bëjë me shëndetin apo me
12 ndonjë kusht specifik të të akuzuarit.

13 Avokati për z. Gucati, ndërkohë që shikoj që avokati për
14 z. Haradinaj është në këmbë.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Thjesht dua t'ju them që neve e
16 tërheqim kërkesën në këtë fazë si prematurë dhe nuk ju
17 kërkojmë që të merremi me këtë çështje sot.

18 Ndërkohë që sa i takon mbajtjen në paraburgim do e
19 trajtoj këtë çështje pasi të flasë z. Rees.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
21 Faleminderit shumë. Se edhe unë në fakt të njëjtën gjë do të
22 thoja që kërkesa juaj është e parakohshme.

23 Mbrojtja për z. Gucati

24 Z. REES: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, sa i takon

1 pozicionit të përgjithshëm të mbajtjes në paraburgim neve kemi
2 parashtruar një përgjigje lidhur me kërkesën e Prokurorisë për
3 sa i takon mbajtjes në paraburgim dhe nuk kam asgjë tjetër për
4 të shtuar lidhur me këtë gjë.

5 E vetmja gjë tjetër që duam që të zgjidhet lidhur me
6 seancën e ditës së sotme është një përditësim që ka të bëjë me
7 shëndetin e z. Gucati.

8 Z. Gucati, ne e kuptojmë dhe kjo është mbase diçka për të
9 cilën do të na duhet që të kalojmë në seancë private, e
10 nderuar Gjykatëse.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull,
12 le të kalojmë në seancë private atëherë.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse,

24 jemi tani në seancë publike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.

1 Mbrojtësi i z. Haradinaj, keni ndonjë gjë për të shtuar, sa i
2 takon mbajtjes në paraburgim të z. Haradinaj?

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Sa për t'ju thënë që pozicioni
4 është lënë i hapur në mënyrë që të merrnim disa udhëzime nga
5 z. Haradinaj. Pasi e kemi bërë këtë gjë, më duhet të them që
6 nuk kemi asnjë parashtrim shtesë sa i takon mbajtjes në
7 paraburgim të z. Haradinaj për momentin.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Z. Prokuror, keni ndonjë gjë për të shtuar?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, e nderuar
12 Gjykatëse.

13 z. Rees tha që kërkohet një përgjigje për sa i takon
14 parashtrimin të protokolluar F10 për sa i takon mbajtjes në
15 paraburgim të të akuzuarit. Nuk ka një përgjigje të tillë në
16 dosjen e çështjes dhe ne nuk gjejmë asnjë mangësi lidhur me
17 numrat e parashtrimeve të protokolluara që u thanë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po, z. Rees

19 Z. REES: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, shpresoj që ju
20 ta keni lexuar përgjigjen.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Jo, nuk e
22 kam parë përgjigjen. Nuk di në qoftë se mund të pyes, a e kemi
23 përgjigjen? Jo.

24 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Si është

1 dërguar, përmes mailit, postës apo emailit?

2 Z. REES: [Përkthim] Është dërguar me anë të emailit
3 përmes Njesisë për Menaxhimit e Qendrës së Paraburgimit pasi
4 ramë dakord me [REDAKTUAR]. Pasi kishim vështirësi për ta
5 dërguar këtë parashtrim të protokolluar. Ne e kemi dërguar në
6 këtë mënyrë se besoj se jeni të informuar për problemin që ka
7 pasur sistemi *Legal Workflow*.

8 Fola me [REDAKTUAR]. Ramë dakord me të përmes emailit.
9 Dhe ai më tha që ai do të sigurohej që CMU-ja, pra Njësia për
10 Menaxhimin e Qendrës së Paraburgimit do të përgjigjej përmes
11 kësaj mënyre. E njëjta rrugë është përdorur edhe për
12 parashtrimin për njoftimin e apelit. Sepse përsëri mangësi,
13 kishte probleme me sistemin *Legal Workflow*. Çështja është
14 parashtruar brenda kohës së parashikuar.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do të
16 kontrollojmë. Pra do të kontrollojmë në qoftë se mund ta
17 marrim këtë Njësia e Menaxhimit.

18 Z. REES: [Përkthim] Unë mund t'ju ndihmoj në qoftë se z.
19 Halling mendon që unë po mundohem që të përfitoj, domethënë
20 unë mund ta kaloj shumë shpejt se cila është thelbi i
21 përgjigjes.

22 Ne vumë re që neni 46(8) i Ligjit për Dhomat e
23 Specializuara dhe Prokurorin e Specializuar parashikon që:

24 "Në qoftë se -- me përjashtim të rasteve kur Gjykata e
25 Apelit urdhëron ndryshe, personi i dënuar mbetet në ndalim në

1 pritje të vendimit të apelit”.

2 Edhe përderisa nuk është marrë një vendim nga Gjykata e
3 Apelit, pikëpamja jonë ishte që kërkesa e Prokurorisë nuk
4 ishte as e nevojshme dhe në fakt as nuk kërkonte ndonjë
5 përjashtim dhe si rezultat ne nuk bëmë një -- nuk dhamë një
6 përgjigje materiale lidhur me të.

7 Ajo çfarë bëmë neve, siç tha edhe z. Cadman për klientin
8 e tij, është që ju drejtuam nenit 46(8) për lirim dhe ju
9 referuam kësaj të drejte tonë të parashikuar në nenin 46(8).

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

11 Faleminderit. Faleminderit që e bëtë përmbledhjen dhe do të
12 marrim një vendim lidhur me të kur të vijë koha.

13 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ku jemi
15 tani? Nuk ka gjë tjetër përse i takon mbajtjes në paraburgim?
16 Jo?

17 Pika tjetër në rendin e ditës është progresi i bërë në
18 përkthimin e Aktgjykimit në gjuhën shqipe. Dua t’i kërkoj
19 përfaqësuesit të Zyrës Administrative të marrë fjalën dhe të
20 na informojë lidhur me këtë çështje.

21 Z. NILSSON: [Përkthim] Sa i takon përkthimit të gjykimit
22 në shqip, përkthimi është realizuar në tre faza. Së pari
23 përkthimi i parashikuar pa poshtëshënime do të përfundojë me
24 atë 20 qershor; pastaj 4 korrik do jepet versioni i përkthyer
25 së bashku me poshtëshënimet, por i parashikuar; ndërkohë që me

1 15 gusht do të jepet versionin përfundimtar i Aktgjykimit i
2 rishikuar, pra së bashku me poshtëshënime.

3 Dy afatet e para janë respektuar. Pra, versionin i parë
4 është ngarkuar në sistemin *Legal Workflow* në datën e
5 përcaktuar, më 20 qershor, ndërkohë përkthimi i dytë i
6 parashikuar është mbaruar disa ditë më përpara dhe është
7 ngarkuar në sistem me datë 27 qershor, ndërkohë që punohet
8 tashmë për të dhënë versionin përfundimtar të datës 15 gusht.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
10 Faleminderit. Ju kujtoj palëve që data 15 gusht është katër
11 ditë përpara se sa të dorëzohen dosjet e apelit. Shpresoj që
12 të kuptohet kjo gjë, po megjithatë në qoftë se keni nevojë për
13 një shtyrje kohe, mbajeni parasysh këtë element.

14 Tani le të kalojmë te pikat e mbetura. Sa i takon
15 vendimet që kemi nxjerrë të premtën që shkoi, ne vumë re që të
16 dyja skuadrat duhet që të riparashtrajnë dosjet ose njoftimet
17 e tyre të apelit. Nuk do të bëj komente të gjata lidhur me
18 defektet e njoftimeve të apelit të dorëzuara nga të dyja
19 ekipet e Mbrojtjes, në veçanti nga ekipi i Mbrojtjes së z.
20 Haradinaj.

21 Më lejoni të ritheksoj që Trupi Gjykes nuk është dakord
22 dhe nuk e vlerëson fare mospërbushjen e kërkesave zyrtare për
23 sa i takon apelit.

24 Tani më lejoni që t'i kthehem çështje që është njoftuar
25 nga Mbrojtja e z. Haradinaj. Megjithatë, lidhur me të folëm që

1 në fillim fare, në fillim të kësaj seance, pra, në qoftë se
2 apeli do të organizohet përmes seancave me gojë apo përmes
3 parashtrimeve me shkrim.

4 Siç e thashë edhe në fillim fare të kësaj seance, kjo
5 është një çështje premature, pra është e parakohshme. Ju
6 kujtoj që në pajtim me rregullën 72(3):

7 "Përveç nëse Paneli i Gjykatës urdhëron ndryshe, apelimet
8 të një Aktgjykimi të një Trupi Gjykues sipas nenit 15(2) të
9 Ligjit, trajtohen në mënyrë të përshpejtuar në bazë të dosjes
10 së çështjes. Vendimet mbi apeline të tilla mund të merren
11 tërësisht mbi bazën e parashtrime me shkrim."

12 Pra, mund të bëhet vetëm me shkrim, megjithatë do ta
13 vendosim, kjo është diçka për të cilën ne nuk e kemi vendosur
14 akoma, në vartësi të kërkesës në qoftë se ju kërkoni një
15 seancë gojore apo jo.

16 Nuk kam ndonjë çështje tjetër për të ngritur.

17 Z. REES: [Përkthim] Ka qenë një përdorim efikas i kohës
18 tuaj, e nderuar Gjykatëse.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

20 Faleminderit. Faleminderit të gjithëve.

21 Z. Cadman.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Shkurtimisht, në urdhrin tuaj për
23 të dorëzuar edhe një herë njoftimin që e dorëzuat javën e
24 shkuar dhe e përmendët gjatë ditës së sotme, sipas kërkesës së
25 zotit -- sipas kërkesës që bëri z. Rees, thatë që ishte data

1 12. Dua të, ta, të jemi krejtësisht të qartë që bëhet fjalë
2 për datën 12 edhe për z. Haradinaj.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po, ashtu
4 është. Data 12.

5 Atëherë e pezullojmë këtë seancën, në qoftë se nuk ka gjë
6 tjetër për të diskutuar. Falënderoj palët, Zyrën e
7 Administratores për kontributet e tyre, falënderoj
8 përkthyesit, stenografët, teknikët audio-vizualë dhe teknikët
9 që na kanë ndihmuar gjatë ditës së sotme.

10 Seanca pezullohet.

11 --- Seanca mbyllet në orën 14.22

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25